



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 16 janar 2013

Nr. ref.: RK345/13

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI92/12

Parashtrues

**Sali Hajdari**

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit për pensionet

## GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

### Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës eshtë Sali Hajdari, nga komuna e Gjilanit.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kérkesës konteston Ligjin për pensionet, por nuk cek as numrin e as datën e nxjerrjes së atij ligji.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është kérkesa e parashtruesit të kérkesës që Gjykata Kushtetuese të komentojë Ligjin për pensionet dhe mënyrën e llogaritjes së përvojës së punës.

## **Baza ligjore**

4. Kérkesa bazohet në nenin 113.7 dhe në nenin 21.4 të Kushtetutës, në nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56, paragrafi 2, të Rregullores së punës.

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Parashtruesi i kérkesës, më 12 shtator 2012, i parashtrroi kérkesë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).
6. Me vendimin e Kryetarit (Nr. GJR.92/12, të 5 nëntorit 2012), gjyqtarja Snezhana Botusharova u emërua Gjyqtare raportuese. Po të njëjtën ditë, me vendimin e Kryetarit (Nr. KSH. 92/12) u emërua Kolegji shqyrtares i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.
7. Më 6 dhjetor 2012, pas shqyrimit të raportit të Gjyqtares raportuese Snezhana Botusharova, Kolegji shqyrtares në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović, i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kérkesës.

## **Përbledhja e faktave**

8. Parashtruesi i kérkesës nuk ka ofruar prova që do të ishin domethënëse për vendimin e Gjykatës, edhe pse Gjykata nëpërmjet një shkrese ka kërkuar nga parashtruesi i kérkesës që të plotësojë kérkesën e tij në mënyrën e paraparë me ligj.

## **Pretendimet e parashtruesit të kérkesës**

9. Parashtruesi i kérkesës pretendon:

*"E nderuara Gjykatë po ju drejtohem juve që ta komenton ligjin mbi pensionin, kur është fjalë te shtazhi i punës. Unë kam punuar në BVI për punësim Gjilan para lufte mbi 14 vite dhe pas lufte po në të njëjtën punë punoj që nga mbarimi i luftës që tani quhet QRPP për punësim në Gjilan. Unë tani jam afër pensionimit dhe sipas informatave për të marrë pensionin prej 81 euro, duhet sipas Ligjit që t'i kem shtazh pune mbi 15 vite para lufte. Kurse ky stazhi i pas luftës nuk të njifet dhe mbetesh në pagesën prej 45 euro".*

10. Parashtruesi i kérkesës më tej konsideron:

*"E nderuara Gjykatë, unë shtazh pune i kam krejt 27 vite edhe para lufte dhe pas lufte si është e mundur që të krahasohem si me ata që të cilët nuk kanë as të vetmen ditë pune stazh. Duke e llogaritur 27 vite pune shtazh edhe 10 vite të*

*okupatorit tē egër që më kanë larguar nga puna bëjnë 37 vite pune, dhe prapë tē mbetem si pa asnë ditë mua ma merr mendja që më shkilen tē drejtat e njeriut më këtë Ligj”.*

*“E nderuara Gjykatë kolegët e mi që e pranuan okupatorin dhe mbetën në punë gjatë okupimit ata tanë janë ma në favor dhe po shkojnë në pension me 81 euro kurse unë i gjori mbetem në 45 euro”.*

11. Parashtruesi i kérkesës i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me këtë kérkesë:

*“Për mos me zgjat ma shumë, besoj që e keni kuptuar se qka po kërkoj nga ju. Ju lutem që tē ma ktheni një komentim se kujt duhet t'i drejtohem ose tē pajtoj me këto ligje diskriminuese. Dhe t'i marr qato 45 euro si ata që s'kanë punuar asnjëherë”.*

#### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kérkesës**

12. Për tē qenë në gjendje tē gjykojë pér kérkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari tē shqyrtojë nëse parashtruesi i kérkesës i ka plotësuar tē gjitha kushtet e pranueshmërisë, tē përcaktuara me Kushtetutë dhe tē specifikuara më tej me Ligjin pér Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës.

13. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet nenit 113, paragrafët 1 dhe 7, tē Kushtetutës:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm pér rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.*

*“7. Individët janë tē autorizuar tē ngrënë shkeljet nga autoritetet publike tē tē drejtave dhe lirive të tyre individuale, tē garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi tē kenë shteruar tē gjitha mjetet juridike tē përcaktuara me ligj”.*

14. Në rastin konkret, parashtruesi i kérkesës ka kérkuar “koment pér Ligjin pér pensionet”, i cili ende nuk aplikohet tek parashtruesi i kérkesës, ndërkokë që Kushtetuta, në nenin 113, e definon qartë se kush mund tē kërkojë vlerësimin e kushtetutshmërisë së një ligji.
15. Një kérkesë e tillë, pér “koment pér ligjin pér pensionet” në dobi tē tē gjithë pensionistëve kosovarë, tregon se parashtruesi i kérkesës konteston në abstrakt ligjin në fjalë. Po qe se ky është qëllimi i parashtruesit tē kérkesës, si individ, ai nuk mund tē konsiderohet si palë e autorizuar.
16. Faktikisht, parashtruesi i kérkesës i referohet nenit 113.7 tē Kushtetutës si bazë juridike pér parashtrimin e kérkesës së tij. Përveç kësaj, parashtruesi i kérkesës nuk paraqet argumente me tē cilat do tē dëshmonte se është viktimi e drejtpërdrejtë e miratimit tē këtij ligji.
17. Neni 113, paragrafët 2, 6 dhe 8 tē Kushtetutës, në mënyrë eksplikite përcakton se kush janë palët e autorizuara pér t'iu drejtuar Gjykatës përkitazi me pyetjet në abstrakt tē vlerësimit kushtetues tē ligjit.
18. Përveç kësaj, sistemi i drejtësisë kosovare nuk parashev “*actio popularis*”, që është modalitet i ankesave individuale, çfarë i mundëson cilitdo individ, që tenton tē mbrojë interesin publik dhe rendin kushtetues, t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me rastin e shkeljeve tē tilla, edhe pse nuk e ka statusin e viktimit.

19. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kérkesës nuk është palë e autorizuar për të kontestuar kushtetutshmérinë e Ligjit për pensionet në abstrakt dhe për këtë arsy kjo kérkesë duhet shpallur e papranueshme.

### **PËR KËTO ARSYE**

Në përputhshmëri me nenin 113, paragrafët 1 dhe 7, të Kushtetutës, në përputhshmëri me nenet 46, 47 dhe 48 të Ligjit si dhe në përputhshmëri me rregullin 36 (1a) dhe (3c) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, në seancën e mbajtur më 6 dhjetor 2012, njëzëri:

### **VENDOSI**

- I. TA HEDHË POSHTË kérkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**

Snezhana Botusharova

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. dr. Enver Hasani

